

URDHËR
Nr. 456, datë 19.8.2022

PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Në mbështetje dhe zbatim të nenit 11/b, të ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat”, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të nenit 11, pikave 2 dhe 3, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, z. Arben Dervishllari, drejtori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, për shkak të mungesës së titullarit të këtij institucioni.
2. Kompetencat e drejtorit të përgjithshëm të Arkivave do të ushtrohen për periudhën nga data 22.8.2022 deri në datën 29.8.2022.
3. Krahas kompetencave të titullarit, në datat 25 dhe 26.8.2022, do të firmosë edhe përgjigjet e kërkesave të përshpejtuara social-juridike të qytetarëve.
4. Nuk delegohen kompetencat e drejtuesit lidhur me personelin, si dhe kompetencat e tjera të padelegueshme, të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.
5. Për veprimet e kryera në zbatim të këtij urdhri, drejtori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, do të ruajë kopje të kartelave shoqëruese të praktikave shkresore, të iniciuara apo të përfunduara prej tij, së bashku me afatet e përcaktuara dhe ecurinë e mbarëvajtjen e çështjeve, dhe do t’ia bëjë të ditura titullarit me rikthimin e tij në detyrë.
6. Për zbatimin e urdhrit ngarkohet drejtori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, z. Arben Dervishllari.
Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Ardit Bido